



Roli i pushtetit vendor për intesifikimin e shkëmbimeve midis Shqipërisë dhe Kosovës dhe integrimin në BE

Dr. Engjëllushe ZENELAJ

Kolegji Universitar "Reald", Vlorë - Albania
enxhizenelaj@gmail.com

Abstract

On the road to integration into the European Union, Albania and Kosovo are faced with a series of conditions, mostly in the form of reforms, the overall goal of which is to strengthen institutions for good governance. However, the ability to govern and manage it can not be effective if it is perceived as a closed process, but instead co-operation with units of local self-government in the country and abroad is an alternative for both sides. The purpose of the article is to highlight the role of local government in enhancing and intensifying exchanges and relations between Albania and Kosovo and EU integration. The article has several objectives, firstly, aims to identify why local government can play an important role in this process of rapprochement and cooperation, secondly aims to identify the importance of this cooperation, thirdly, aims to analyze the benefits of these agreements and collaborations suggesting some forms of cooperation through agreements and analysis and concrete consequences that these forms of cooperation may have. For the realization of this article, several research methods have been used, such as research in order to observe the current cases of successful developments, secondly, the analysis method was used to analyze the concrete situation of local government in Albania and Kosovo. thirdly, the synthesis method was used to synthesize the knowledge and practices so far and their adaptation to the case of cooperation between Albania and Kosovo. The article aims to be in a form of recommendation for the ways and forms of cooperation by identifying the importance of cooperation, but not merely in the theoretical plan, but addressed in concrete form, identifying the forms of cooperation, the importance of increasing the role of local government also for integration into the EU.

Key words: a unit of local self-government, cooperation, exchanges, development, good governance.

Abstrakt

Në rrugën për integrimin në Bashkimin Europian, Shqipëria dhe Kosova janë vendosur përballë një serie kushtesh, të cilat më së shumti janë në formën e

reformave, qëllimi i përgjithshëm i së cilave është forcimi i institucioneve për mirëqeverisje. Gjithsesi, aftësia për të qeverisur dhe miradministruar, nuk mund të jetë eficientë nëse perceptohet si një proces i mbyllur, por përkundrazi bashkëpunimi me njësi të vetëqeverisjes vendore brenda dhe jashtë vendit është një alternative për të dyja palët. Karakteristikat e njësive të vetëqeverisjes vendore, si në Shqipëri dhe në Kosovë pothuajse janë të ngjashme, që nga çështjet e buxhetit, niveli i kapaciteteve humane në administratë, aftësia dhe cilësia e menaxhimit dhe e administrimit, transparencja, dhe rezultatet e eficiencës së qeverisjes. Qëllimi i artikullit është që të evidentoj rolin e pushtetit vendor për rritjen dhe intesifikimin e shkëmbimeve dhe marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kosovës si dhe integrimin në BE. Artikulli ka disa objektiva ku së pari, synon të identifikojë se pse pushteti lokal mund të luajë një rol të rëndësishëm për këtë proces afrimi dhe bashkëpunimi, së dyti synon të identifikojë rëndësinë e këtij bashkëpunimi, së treti synon të analizojë përfitimimin nga këto marrëveshje dhe bashkëpunime duke sugjeruar disa forma bashkëpunimi nëpërmjet marrëveshjeve dhe analizën e pasoja konkrete që mund të kenë këto forma bashkëpunimi. Për realizimin e këtij artikulli janë përdorur disa metoda studimi, si ajo e hulumtimit me qëllim vëzhgimin e rasteve të deritanishme të zhvillimeve të suksesshme, së dyti është përdorur metoda e analizës me qëllim analizimin e situatës konkrete të pushtetit vendor në Shqipëri dhe në Kosovë, së treti është përdorur metoda e sintezës, me qëllim sintetizimin e dijeve dhe praktikave të deritanishme, si dhe përshtatjen e tyre për rastin e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Kosovës. Artikulli synon që të jetë në formë rekomanduese për mënyrat dhe format e bashkëpunimit duke identifikuar rëndësinë e bashkëpunimit, por jo thjesht në planin teorik, por i trajtuar në formë konkrete, duke identifikuar format e bashkëpunimit, rëndësinë e rritjes së rolit të pushtetit vendor edhe për integrimin drejt BE.

Fjalë Kyçe: njësi e vetëqeverisjes vendore, bashkëpunim, shkëmbime, zhvillim, mirëqeverisje.

1. Hyrje

Megjithëse përfaqësuesit vendorë dhe rajonalë nuk marrin një rol më të rëndësishëm në procesin formal të integrimin, në të cilin fokusi është mbi sovranitetin



- politikat nën traktatin e Romës, vetëm shtetet kanë personalitet juridik - veprimtaria e tyre në arena të ndryshme promovon procesin e integritimit joformal në BE (Gidlund, J; Jerneck, M;, 2000, p. 29). Ndikimi i integritimit evropian, megjithatë, nuk është një rrugë me një drejtim. Anëtarësimi në BE u ka dhënë gjithashtu autoriteteve lokale dritare të mundësive që ndryshuan vendimet vendore dhe inkurajuan sipërmarrjen komunale për të nxitur shqetësimet lokale në skenën evropiane (Fleurke, F; Willemse, R;, 2006), (Guderjan, 2012). *Bashkimi Evropian është plotësisht i vendosur të mbështesë Shqipërinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE* (Vokopola,Z.; Kallamata,E;, 2018) . Në serinë e kushteve integruese për në Bashkimin Europian përfshihet edhe efektiviteti i qeverisjes vendore. Reforma territoriale në Shqipëri solli ndryshime të ndjeshme në hartën administrative të vendit si dhe në organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore. Pashmangshmëria e decentralizimit të pushteti vendor rezulton në një vëmendje të vecantë nga Bashkimi Europian. Përfaqësuesit e autoriteteve lokale duhet të jenë të përgatitur për të ripërcaktuar marrëdhëniet me statusin dhe në të njëjtën kohë që ato hyjnë në lidhje me palët e reja jashtë territorit të tyre (Gidlund, J; Jerneck, M;, 2000) . Pas reformës së ndarjes administrative, njësitë e reja të vetëqeverisjes vendore janë përfshirë në model të ri të organizimit dhe funksionimit në pikëpamjen e kompetencave të pushtetit vendor. Zgjerimi i kompetencave të cilat synojnë decentralizimin e pushtetit, kanë reflektuar sa në zhvillime të reja të cilat identifikojnë sfidat që përballen njësitë e vetëqeverisjes vendore. Përkundër faktit se ata nuk marrin pjesë në procesin e qeverise, ato janë shumë aktive në procesin e qeverisjes (Gidlund, J; Jerneck, M;, 2000, p. 29).

2. Metodologjia

Ky punim është ndërtuar me integrimin e disa metodave të studimit si vëzhgimi, hulumtimi, analiza dhe sinteza. Puna vjen si pasojë e një vëzhgimi të gjatë, ndërsa punon si një specialist apo shef sektori në njësinë e qeverisjes vendore, dhe veçanërisht nga rezultatet e arritura gjatë reformës territoriale. Kjo praktikë ka kontribuar në sqarimin e funksionimit të efekteve konkrete të gjithçkaje që trajtohet në teori për qeverisjen vendore, por edhe për eksplorimin e mëtejshëm në këtë fushë. Përveç kësaj, artikulli i kushton vëmendje studimeve dhe analizave të autorëve, institucioneve dhe organizatave të ndryshme të cilat kanë përqëndruar vëmendjen në zhvillimin e qeverisjes vendore, integrimin në BE dhe rolin e qeverisë lokale për integrimin evropian. Rezultatet e hulumtimit të studimeve dhe publikimeve, rezultatet e arritura nga institucionet e angazhuara për qeveritë lokale, si dhe monitorimi në njësinë e qeverisjes vendore për secilin vend, janë analizuar dhe sintetizuar për ta bashkuar atë në formën e një artikulli.

3. Sfidat e pushteti vendor në Shqipëri dhe Kosovë

Njësitë e vetëqeverisjes vendore si në Shqipëri dhe në Kosovë kanë avantazhe dhe disavantazhe, megjithatë në kontekstin e problematika të cilat shtrohen si sfida

përballë fuqizimit të tyre janë pothuajse në të njëjtin nivel. Disa nga dobësitë e njërive të vetëqeverisjes vendore në Kosovë dhe Shqipëri janë:

- **Buxheti**- Fakti që njësitë e vetëqeverisjes varen më së shumti nga financimi i qeverisë qendrore, është një tregues i dobësisë së tyre. Pafuqia financiare e NJQV (Njësi e Qeverisjes Vendore) i kufizon ato edhe në vendimmarrje dhe qeverisje eficiente, dhe përveç kësaj edhe vlera shumë e ulët e buxhetit nuk krijon hapësira për investime strategjike. Gjithashtu, një tjetër problem në lidhje me buxhetin është keqmenaxhimi i tij, pasi pjesa më e madhe e buxhetit shkon për paga dhe shpenzime administrative-operative por jo për investime.
- **Kapacitetet humane të administratës**- mungesa e kapaciteteve humane evidentohet në të dyja rastet sidomos gjatë kontrollit që ushtrojnë institucionet audituese, duke evidentuar shkelje të cilat më shumti lënë të kuptosh për mungesë njohurisë se sa veprime tendencioze, abuzive apo korruptive. Auditimet për cilësinë dhe performancën e institucioneve nxjerrin në pah mungesën e aftësive profesionale për procedurat administrative. Një tjetër tregues është mungesa e aplikimeve në projekte të cilat financohen nga BE. Përpos problemit të "profesionalizimit" të administratës lokale, problem tjetër i administratës lokale është edhe politizimi i saj, i cili problem në vend që të menaxhohet dhe të gjendet zgjidhja e tij, ai vetëm sa po shkon e po bëhet edhe më i pa zgjidhshëm, dhe po shkon në funksion të rritjes së pa nevojshme të numrit të të punësuarve në administratën lokale, e cila për çdo ditë ballafaqohet me kërkesën e sistemit të punëtorëve (Haliti, B; Hyseni,F;, 2011).
- **Kontrolli i territorit**- në të dyja rastet evidentohet prej vitesh shkelja e rregulloreve për ndërtim, dhe mosrespektimi i planeve të përgjithshëm apo lokal rregullues. Në disa raste janë evidentuar ndërtime në zonat arkeologjike apo jashtë standardeve dhe kritereve të sigurisë për ndërtime.
- **Planet dhe strategjitë me baza konkrete zhvillimi**- agjencitë e huaja të zhvillimit vazhdimisht investojnë për hartimin e planeve lokale të zhvillimit apo strategjive, por fakti që shumica e këtyre planeve nuk janë eficientë nxjerr në pah dhe mungesën e karakterit aplikativ real për kapacitetet konkrete që ka NJQV. Institucionet e qeverisjes lokale në Kosovë shfaqin luhatje të mëdha në treguesit e efikasitetit, që kanë të bëjnë me raportimin, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve dhe politikave, dhe planifikim strategjik ku në nivel rajonal renditen të parafundit në ndërgjegjësim me 29.2% të kritereve të përmbushura, ndërsa Shqipëria mbetet prapa me 20.1%, Mali i Zi është përpara të gjithëve me 65.4% (Meta Shala,B ; Garaiova, A;, 2017).
- **Vizioni kreativ dhe aplikativ për mirëqeverisje**- të zgjedhurit me votë nga populli, në shumicën e rasteve janë sipas votave politike. Ende nuk është e përhapur totalisht kultura e votës për individin mbi bazën e asaj se çfarë ai prezanton në fushatë elektorale. Zgjedhja e individëve mbi votë partiake, ose për shkak të



bindjeve politike në garën elektorale për drejtues të NJQ-ve, në shumicën e rasteve sjell një fitore të lehtë për bastionet partiake, por një humbje të rëndë për komunitetin pasi garancia për fitore politike zbeh dëshirën dhe vullnetin për punë të drejtuesve të NJQV-ve.

- **Vendimet Politike-** Politizimi i theksuar në vendimmarrje vërehet si në këshillat lokal por edhe në vendimmarrje administrative. Mungesa e pjekurisë politike reflektohet në aftësinë dhe mënyrën e vendimmarrjes me karakter politik, si në rastet e bllokimit të funksionimit të NJQV nga mungesa e vendimmarrjes së këshillave lokale për shkaqe politike, apo vendimmarrje e njëanshme në favor të objekteve dhe subjekteve të cilët janë të njohur për shërbime ndaj forcës politike në pushtet.
- **Administrim territorit dhe i resurseve-** Prishja e sistemit urban si dhe dëmtimi resurseve natyrore është rezultat i një administrimi jo eficient i cili reflekton në të gjithë aktorët dhe faktorët e NJQV.
- **Tarifat dhe taksat vendore** – një nga handikapët e theksuar të NJQV është mbledhja e taksave dhe tarifave vendore. Mosmbledhja e taksave dhe tarifave vendore krijon deficiencë në buxhetin e parashikuar, një pjesë e të cilit do të shkojë si pjesë integrale për investime strategjike ose investime të tjera.
- **Transparenca me publikun për procesin e vendimmarrjes** - tipike për të dyja palët është zbardhja jo vetëm e vendimmarrjes por mbi të gjitha e gjithë procesit që nga projektpropozimi, ose projektvendimi deri në vendimmarrjen përfundimtare. E gjithë rruga për vendimmarrjet lokale si në ato të organeve kolegjiale (këshillat lokale) por edhe vendimmarrje administrative nuk bëhet e qartë për komunitetin. Baza ligjore është plotë në të dyja shtetet. Ashtu si në tregues të tjere edhe për ceshtjen e transparencën në rajonin e Ballkanit perëndimor, Kosova (27.5%) rezulton më lartë se Shqipëria (9.5%), ndërsa kryeson Mali i Zi me 58% (Meta Shala,B ; Garaiova, A,, 2017).

E gjitha sa më sipër, evidenton një seri problematikash të ngjashme midis NJQV në të dy shtetet. Megjithatë edhe si shkak i reformave dhe i qëllimit të përbashkët që kanë të dy shtetet për rrugën europiane, duhet synuar rritja dhe forcimi i rolit të NJQV shërben për qëllimin dhe interesat kombëtar. Hapja e qeverisjes lokale është një element thelbësor në bashëpunimin e përfaqësuesve politik me qytetarët dhe krijimin e lidhjeve të forta ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve publike. Në krahasimin rajonal të qeverisjeve lokale, Kosova gjendet gati në fund me vetëm 26.7% të kriterëve të përmbushura. Shqipëria e fundit, shënon vetëm 12.1% ndërsa Mali i Zi më i suksesshmi përmbush 57.5% të tyre (Meta Shala,B ; Garaiova, A,, 2017).

4. Roli i pushteti vendor për intensifikimin e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Kosovës.

Pse pushteti lokal?

- Sepse janë më afër komunitetit.

- Janë në kontakt të drejtpërdrejtë me komunitetin.
- Ata e njohim me detaje zonën që administrojnë dhe qeverisin.
- Burokracitë janë më të pakta dhe projektet e bashkëpunimit mund të jenë më reale dhe më të arrishtme në kohë, të ndjeshme dhe të prekshme për komunitetet.
- Pushteti lokal është promotorë për indiciet për zhvillimin e komunitetit lokal.
- Domosdoshmëria për rritjen e kapaciteteve humane dhe kapërcimin e sfidave.
- Rritja e aftësive projektuese dhe zhvilluese e drejtuesve të NJQV.
- Ruajtja e lidhjeve dhe vlerave të trashëgimisë etnografike, kulturore, shpirtërore, natyrore
- Identifikimi i projekteve potenciale për NJQV dhe përpilimi i hapave konkret për implementimin e tyre.

Pse duhet ky bashkëpunim?

- Duke punuar së bashku do të çojnë më tej idetë për zhvillimin e komuniteteve.
- Do të përforcohet parimi "*think global, act local*"
- Angazhim më eficient për hartimin e strategjive dhe planeve të zhvillimit
- Intensifikimi i shkëmbimeve të kapitalit human dhe material
- Nxitje për përdorimin eficient dhe të qëndrueshëm të resurseve lokale
- Iniciativa dhe Praktika të përbashkëta për të edukuar vendimmarrjen transparente në nivel vendor.

Cili është përfitimi për këto marrëveshje?

Në marrëveshjet e bashkëpunimit midis njësive të vetëqeverisjes vendore

Alternativa dhe mënyra bashkëpunimi:

- Organizimi i marrëveshjeve për shkëmbimet e stafeve të bashkive në periudha të caktuara.
 - Prezantimi i dhomave të tregtisë që funksionojnë në NJQV.
 - Prezantimi dhe njohja me vlerat e veçanta të secilës NJQV.
 - Organizimi i panairove lokale.
 - Marrëveshje për shkëmbimet e nxënësve të arsimit parauniversitar.
 - Organizimi i tureve të përbashkëta dhe vizitave studimore.
 - Shkëmbimi i stafeve të institucioneve arsimore parashkollore.
 - Ofrimi i bursave për studime.
 - Ofrimi i praktikave të paguara për të diplomuarit.
- b. Pasojat:
- Forcimi dhe rikonceptimi i autonomisë vendore.
 - Rritja e kapaciteteve humane.
 - Shkëmbimi i praktikave institucionale.
 - Rënia e barrierave të komunikimit.
 - Intensifikimi i komunikimit dhe shkëmbimeve të kapitalit human.
 - Intensifikimi i komunikimit dhe shkëmbimeve të ideve.
 - Rritja e shkëmbimeve tregtare dhe nxitja për sipërmarrje të përbashkëta.



- Rritja e konsumit të produkteve lokale.
- Rritja e marketingut për konsumin e produkteve lokale.

Pushteti vendor dhe integrimi në BE

Përmes zbatimit të politikave të BE-së, njësitë vendore mbajnë një pjesë të madhe në suksesin e procesit të integritit (Derenbach, 2006).

- BE në bashkinë time.
- Rritja e fondeve dhe granteve për investime të projekteve për NJQV.
- E drejta e NJQV për të aplikuar drejtpërdrejt pa partneritet për thirrje të BE për projekt propozime apo projekte infrastrukturore. Për shkak të strukturës së re të mundësive të ofruara nga politika rajonale dhe kohezioni e BE-së, autoritetet lokale kanë mundësi të ndërveprojnë me institucionet në nivele të ndryshme (Guderjan, 2012).
- Tashmë BE është ulur këmbëkryq në NJQV, është

detyra e njësite të vetëqeverisjes vendore që të përfitojmë. Integrimi në BE kërkon edhe integrimin në nivel multiqeverisje, andaj dhe përfshirja e pushtetit vendor për qasja e yre me direktivat e BE.

- Së pari, i bën njësitë e qeverisjes vendore të ndjehen pjesë e procesit të integritit.
- Së dyti, nxit përirësimin e procesit të vendimmarrjes dhe politikëbërjes sipas orientimeve të BE.
- Së treti, nxit dhe më shumë rritjen e kapaciteteve humane të cilat janë çelësi që venë në lëvizje të gjithë institucionin.
- Së katërti, sjell përfitime të drejtpërdrejta për projekte konkrete në fusha të ndryshme.
- Së pesti, e edukon dhe formon brezin e ri me prezencën dhe frymën e BE, duke mos e perceptuar BE si dicka të largët, por prezente në edhe vendbanimin e tyre.

Works Cited

Derenbach, R. (2006). Die stärkere Einbindung der lokalen Gebietskörperschaften in das europäische Aufbauwerk: Partnerschaft im Modell der „multilevel governance“ statt zunehmender Entfremdung. In M. C. Alemann U., *Europafähigkeit der Kommunen. VS Verlag für Sozialwissenschaften* (pp. 77-101). Wiesbaden: VS Verlag für Sozialwissenschaften.

Fleurke, F; Willemse, R;. (2006). "Measuring local autonomy: A decision-making approach, " *Local Government Studies* , 32 (1): 71-87.

Gidlund, J; Jerneck, M;. (2000). *Local and regional governance in Europe, Evidence from Nordic Regions*. Cheltenham UK, Northampton MA USA: Edward Elgar.

Guderjan, M. (2012). Local Government and European integration— beyond Europeanisation? *Political Perspectives* , volume 6 (1), 105-128.

Haliti, B; Hyseni,F;. (2011, November 12). *opinione*. Retrieved December 21, 2017, from Telegrafi.com: <https://telegrafi.com/sfidat-e-funksionimit-te-qeverisjes-lokale-ne-kosove-ne-aspektin-financiar-dhe-administrativ/>

Meta Shala,B ; Garaiova, A;. (2017). *Qeverisja e Hapur e Pushtetit Lokal në Rajon dhe Kosovë*. Prishtine: European Unionas part of the ACTION SEE – Accountability, Technology and Institutional Openness Network in SEE Project.

Vokopola,Z;. Kallamata,E;. (2018). *MUNICIPALITIES IN THE EU INTEGRATION PROCESS OF ALBANIA*. Tirana: Bashkrite per ne Evrope, Projekt i Bashkimit Europian.